



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1070_12_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 17.01.2014.

në seancën e mbajtur më datë 12 mars 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin S.D., me shifër të konsumatorit: DPR – 95169) nga Besiana ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1070_12_13 i datës 05.12.2013.

Arsyetim

Me datë 09.08.2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 9852613 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 4747938, dhe se njehsori duhet të dërgohet në qendrën për kalibrim.

Me datë 27.08.2007 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 9852613, ku është konstatuar se njehsori elektrik bllobat shtetërore një e ka në rregull, për rreth qelqit nga ana e majtë dhe kapakut të epërm nga ana e djathtë është futur shiriti filmik, është penguar puna e diskut, si dhe në brendi të njehsorit ka pluhur të shiritit filmik.

Me datë 24.09.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut, për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatori, ku kanë konstatuar se në bazë të procesit të kalibrimit kemi dal në vend për të marr seksionin e kabllit furnizues dhe gjatë inspektimit të kësaj pike matëse ka qenë prezent djali i pronarit S.D.

Me datë 11.11.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06804 në vlerë prej 289.80€.

Me datë 30.01.2009 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrik, procesverbalin e kontrollës dhe procesverbalin e kalibrimit.



Në bazë të ankesës së konsumatorit të datës 18.12.2008, Departamenti për Konsumator në KEK me datë 30.01.2009 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij dhe duke u thirrur në Procedurën për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrik, procesverbalin e kontrollës dhe procesverbalin e kalibrimit.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 09.02.2009 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 05.12.2013 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: KKDFE duhet të shkarkojë konsumatorin me shifër DPR – 95169 nga fatura e shfrytëzimit të paautorizuar (rikthim i humbjeve) DPR08HP06804 të datës 11.11.2008 në vlerë prej 289.80 €.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 17.01.2014 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes dhe zbatimit të gabuar të dispozitave ligjore.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se sektori i kalibrimit ka konstatuar se njehsori është i keqpërdorur nga ana e konsumatorit ku për rreth qelqit nga ana e majtë dhe përreth kapakut të epërm nga ana e djathtë është futur shiriti filmik me të cilën është penguar puna e diskut.

Gjithashtu përveç konstatimeve nga ana e kalibrimit si argument shtesë për ngarkesë me faturën e rikthimit të humbjeve është edhe rrjedha e energjisë elektrike që dëshmon keqpërdorimin ani pse mendojmë se rrjedha e energjisë e shpenzuar nuk është tregues i vërtet se a ka apo nuk ka manipulim të njehsorit elektrik. Gjithashtu në ankesë është theksuar se DMK e ZRRE-së gjatë nxjerrjes së vendimit nuk ka poseduar aktgjykimin e gjykatës komunale në Podujevë me të cilin është shpallur konsumatori fajtor për veprën penale nga neni 252 par. 1 i KPK-së.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 mars 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara.

Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës e posaçërisht procesverbalit të kalibrimit dhe rrjedhës së energjisë elektrike ka vërejtur se konsumatori nga perioda e ndërrimit të njehsorit elektrik ka rënie të shpenzimit të energjisë elektrike, që nëse krahasojmë këtë me mesatare të shpenzimit del se mesatarja e shpenzimit të energjisë para ndërrimit të njehsorit elektrik ka qenë 917 kWh/muaj, ndërsa pas ndërrimit të njehsorit elektrik del se mesatarja mujore e shpenzimit është 740 kWh/muaj. Nga kjo analizë vërehet se te ky konsumator nuk ka indikacione të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së, ka vërejtur se Departamenti i Faturimit në KEK gjatë faturimit të konsumatorit me shfrytëzim të paautorizuar ka gabuar ngase nuk ka zbatuar dispozitat e sakta të procedurës e cila ka qenë në fuqi në atë periudhë, Gazeta e KSAK-u. Departamenti i Faturimit në KEK e ka faturuar konsumatorin me shfrytëzim të paautorizuar duke u bazuar në të dhënat e procesverbalit të datës 14.06.2008, pra sipas profilit të siguresave. Sipas kësaj vërehet se kjo formë e llogaritjes ka qenë gabim ngase është dashur të merren pajisjet dhe të regjistrohen fuqitë e pajisjeve dhe të zbatohet mënyra e llogaritjes e specifikuar në Gazetën e KSAK-ut. Po ashtu duhet theksuar se procesverbali i ndërrimit të njehsorit elektrik ka qenë me datë 29.03.2007 dhe i kalibrimit me datë 06.04.2007, ndërsa fatura e shfrytëzimit të paautorizuar është bërë me datë 1607.2009.

Sa i përket konstatimeve nga laboratorit i kalibrimit lidhur me gjendjen e njehsorit elektrik Bordi i ZRRE-së nuk i ka falur besimin këtyre konstatimeve pasi që në procesverbal thuhet se njehsori elektrik ka pluhur nga futja e shiritit filmik, ndërsa nga fotografitë e siguruara nga kjo qendër nuk



vërehet se ka ndonjë pluhur të shiritit filmik. Gjithashtu është vërjetur se njehsori elektrik ka qenë prodhim i vitit 1978, dhe se nga kjo periudhë e tutje nuk ka asnjë të dhënë se njehsori elektrik të ketë qenë i kalibruar. Sipas nenit 8 paragrafi 8.3 të procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike theksohet: *“Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritorë për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur”*.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit nga ana e KEDS, se lidhur me këtë çështje është zhvilluar procedurë penale ndaj këtij konsumatori i cili është dënuar nga gjykata me aktgjykim të formës së prerë për veprë penale vjedhje nga neni 252 paragrafi 1 i KPK-së. Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të edhe kësaj pike ka konstatuar se vendimi i DMK-së është nxjerr në përputhje të plotë me Rregullën për zgjidhjen e ankesave dhe kontesteve në sektorin e energjisë, pasi që kjo rregull i ka dhënë të drejtë ligjore që konsumatori të parashtojë ankesë në DMK, duke kundërshtuar faturën e rikthimit të humbjeve, andaj mbi bazën e kësaj DMK ka vendosur në përputhje të plotë me këtë rregull.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1070_12_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar